



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 759, Datë 30.12.2020

**“Mbi bashkimin me përthithje të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria
Vodafone Albania SHA.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 30.12.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Njoftimi i bashkimit me përthithje të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA.

Baza Ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi njoftimin e bashkimit me përthithje të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA.

VËREN SE :

Procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi mbi bashkimin me përthithje të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA.

Më datë 15 Tetor 2020, shoqëria Vodafone Albania SHA (ortaku i vetëm i shoqërisë ABCom SHPK) dhe shoqëria ABCom SHPK kanë nënshkruar “Projekt Marrëveshjen e Bashkimit me Përthithje”. Sipas dokumentit “Raporti i Bashkimi me Përthithje i Shoqërive”, parashikohet se bashkimi i shoqërive nënkupton transferimin e të gjitha aktiveve dhe pasiveve nga shoqëria e përthithur tek shoqëria përthithëse. Vlerat e aktiveve dhe pasiveve do të saktësohen në pasqyrat financiare të 31 dhjetor 2020.

Shoqëria Vodafone Albania SHA fitoi kontrollin e vetëm të shoqërisë ABCom SHPK nëpërmjet dokumentit “Marrëveshja për Shitje dhe Blerje”, të datës 25 tetor 2019.

Transaksioni u njoftua pranë Autoritetit dhe iu nënshtrua procedurave të kontrollit të përqendrimeve të parashikuar në nenet 10; 12 dhe nenet 53-64 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar. Gjatë vlerësimit të efekteve të transaksionit, Komisioni i Konkurrencës konstatoi se shoqëria Vodafone Albania SHA siguronte pjesën më të madhe të të ardhurave nga shërbimet e komunikimeve elektronike, zotëronte pozitë dominuese në tregun e komunikimeve elektronikë në rrjetin celular, kishte eksperiencë e saj dhe të grupit që përfaqësonte dhe transaksioni do të sillte impakt në tregun e komunikimeve elektronike, dhe kryesisht në tregun e komunikimeve në rrjetet fikse.

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 676 datë 07.02.2020 “Mbi autorizimin me kushte dhe detyrime të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA”, autorizoi ndryshimin e kontrollit me kushtet dhe detyrimet si më poshtë:

a. Detyrimin e shoqërisë Vodafone Albania SHA të mos abuzojë më pozitën e saj dominuese nëpërmjet :

- (i.) Vendosi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të çmimeve të padrejta të tregtimit dhe detyrimin e orientimit e tyre drejt kostos së shërbimeve,
- (ii.) Vendosi së palëve në kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta, e të pafavorshme për konkurrencën,
- (iii.) Vendosi e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, ku këto të fundit të pranojnë detyrime shtese, të cilat nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.

b. Detyrimin e shoqërisë Vodafone Albania SHA dhe ABCom SHPK, për ndarjen e llogarive ekonomike për shërbimet e telefonisë fikse dhe celulare, e cila do të bëjë të mundur evidentimin e burimit të gjenerimit të të ardhurave.

Për vlerësimin e zbatimit të kushteve dhe detyrimeve të dhëna, Autoriteti është duke monitoruar sjelljen e shoqërive Vodafone Albania SHA dhe ABCom SHPK në tregun e komunikimeve elektronike.

Transaksioni i njoftuar, mbi bashkimin me përthithje të shoqërisë ABCom SHPK nga Vodafone Albania SHA, nuk konsiston në një ndryshim kontrolli sipas parashikimeve të nenit 10 të ligjit nr 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, dhe për këto arsye nuk kërkon autorizimin nga Komisioni i Konkurrencës.

Por, shoqëritë Vodafone Albania SHA dhe ABCom SHPK mbartin detyrime të përcaktuara nga Vendimi nr. 676 datë 07.02.2020 “Mbi autorizimin me kushte dhe detyrime të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA” dhe transaksioni i bashkimit me përthithje do të ndikojë në zbatimin e kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në këtë vendim.

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 39 e Ligjit 9121/2003 dhe nenit 20 të Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, në datë 23.12.2020 organizoi një seancë dëgjimore me palët në marrëveshjen e bashkimit me përthithje.

Gjatë seancës dëgjimore, shoqëria Vodafone Albania SHA mori angazhimin për zbatimin e kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në Vendimi nr. 676 datë 07.02.2020 “Mbi autorizimin me kushte dhe detyrime të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA” edhe pas përthithjes së shoqërisë ABCom SHPK.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Mos klasifikimin si përqendrim të bashkimit me përthithje të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA.
2. Detyrimin e shoqërisë Vodafone Albania SHA për zbatimin e pikës 1, germa a) të vendimit Nr. 676 datë 07.02.2020 “Mbi autorizimin me kushte dhe detyrime të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA”.
3. Detyrimin e shoqërisë Vodafone Albania SHA për marrjen përsipër të të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që do të lindin nga procedura e bashkimit me përthithje.
4. Vazhdimin e periudhës së monitorit të veprimtarisë së shoqërisë Vodafone Albania SHA deri në 31 dhjetor 2021.
5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS